

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br.Prot.
Nr. I faq.	Prot No.
Broj stranica	01-5066/14
Nr. pages	02
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 22.12.2014, mori:

**V E N D I M**

**I.** Mbylljet rasti me nr. AKK-03-4262/14, për znj. Gentiana Islamaj, Udhëheqëse e Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për shkak se zyrtarja e lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtimin e Funksionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Gentiana Islamaj, Udhëheqëse e Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtarja e lartë znj. Islamaj është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtimin e funksionit publik. Fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit, Pas pranimit të kësaj shkresë, kemi njoftuar zyrtaren e lartë me fakte për situatën e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, në të cilin ndodhet.

Zyrtarja e lartë znj. Islamaj ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtarja e lartë znj. Islamaj ka sjellë në Agjenci një shkresë zyrtare (DPKI-03-5041) (DPKI-03-5042), në të cilën vërtetohet se e njëjtë është larguar nga funksioni si person i autorizuar në bizneset private Koumakis Kosovo L.L.C dhe A.I.G Inter Consul Management S.R.L – Dega Kosovë, për të ushtruar funksionin publik si Udhëheqëse e Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znej. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

